

RAPORT I NDËRMJETËM 4* 19-25 Shkurt 2007

I. PËRMBLEDHJE

- Në vazhdim të Deklaratës së Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake, nxjerrë më 19 shkurt, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ) të OSBE/ODIHR-it vazhdoi monitorimin e hapave të mëtejshëm të procesit zgjedhor, duke u përqendruar në procesin e numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultateve, si dhe në trajtimin e ankimeve dhe apeliemeve.
- Ndërkohë që në shumicën e Njësive të Qeverisjes Vendore (NjQV) të vëzhguara numërimi i votave u zhvillua në mënyrë relativisht të qetë, në të tjera ishte i tejzgjatur dhe polemik. Në disa NjQV numërimi u bllokua disa herë dhe, pati raste ku jo të gjitha kutitë e votimit u numëruan për shkak të mosmarrëveshjeve mes komisionerëve.
- Gjatë numërimit, u duk që disa zyrtarë vunë interesat e partive të tyre përkatëse mbi integritetin e procesit, duke mos arritur kësaj të zbatonin ligjin si administratorë të paanshëm të zgjedhjeve. Kjo solli mosmarrëveshje politike dhe pengesa ndaj procesit të numërimit e për rrjedhojë, gjatë nxjerrjes së rezultateve, u vëzhguan vonesa.
- Në një numër të kufizuar NjQV-sh, procesi i numërimit u njollos nga dhuna e ushtruar mes mbështetësve të kandidatëve dhe partive të ndryshme, si dhe mes anëtarëve të grupeve të numërimit. Të paktën një person u dërgua në spital dhe disa të tjerë u ndaluan.
- Shpallja e rezultateve të zgjedhjeve në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve u bë me shumë vonesë. Kjo gjë, ndonëse iu atribua problemeve me programin kompiuterik, nuk kontribuoi në rritjen e transparencës.
- Policia luajti një rol pozitiv gjatë procesit të votimit dhe atij të numërimit, dhe i përmbushi detyrat e saj në një mënyrë profesionale dhe ne përputhje me ligjin.
- Deri më 25 shkurt, në KQZ u regjistruan 136 ankime kundër rezultateve të zgjedhjeve dhe kërkesa për pavlefshmëri. KQZ-ja ka filluar të marrë në konsideratë pjesën më të madhe të këtyre rasteve. Përveç kësaj, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm ka raportuar se nga 18 deri në 20 shkurt ishin regjistruar 36 kallëzime penale që lidhen me zgjedhjet.
- Një ekip i vogël ekspertësh po ndjek fazat e mëtejshme të procesit zgjedhor.. Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet trajtimit të ankimeve dhe apeliemeve.

* Ky raport është i përkthyer në gjuhën shqipe. Sidoqoftë, varianti në gjuhën angleze mbetet i vetmi dokument zyrtar.

II. HYRJE

Më 19 shkurt MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it dhe Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Europës, nxorën bashkarisht një Deklaratë të Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake, e cila pasqyron zhvillimet e periudhës parazgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR –it vazhdoi aktivitetet e veta vëzhguese duke u përqendruar në numërimin e votave dhe në nxjerrjen dhe shpalljen e rezultateve. Vëzhguesit e OSBE/ODIHR-it raportuan nga 77 vende numërimi. Përveç kësaj, MVZ-ja ndoqi fazat e para të gjyqimit nga ana e KQZ-së së ankimeve kundër vendimeve të KZQV-ve për rezultatet dhe kërkesave për pavlefshmërinë e zgjedhjeve.

Më 20 shkurt, Kryetari i radhës i OSBE-së, Ministri i Jashtëm Spanjoll Miguel Angel Moratinos, nxori një deklaratë me anë të së cilës u drejtohej institucioneve shqiptare dhe partive politike të vazhdonin bashkëpunimin për të realizuar reformën zgjedhore së bashku me OSBE/ODIHR-in.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it do të vazhdojë të monitorojë trajtimin e ankimeve dhe apelimeve. Ajo do të ofrojë një vlerësim të plotë të të gjithë procesit zgjedhor, përfshirë edhe rekomandimet për përmirësime në të ardhmen, në një raport të plotë përfundimtar, që do të dalë brenda dy muajve pas përfundimit të procesit.

III. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Numërimi dhe nxjerrja e rezultateve në KZQV

Pas mbylljes së votimeve, kutitë e votimit u transportuan në 375 vende të numërimit, ku u vazhdua me procesin e numërimit. Në 8 NjQV votimi nuk u krye dhe për rrjedhojë as numërimi i votave. Ndërkohë që numërimi ishte organizuar relativisht mirë në shumicën e vendeve të numërimit të vëzhguara, emërimi me vonesë i anëtarëve të grupeve të numërimit duket se ka rezultuar në trainimin e pamjaftueshëm të komisionerëve, duke çuar në këtë mënyrë në gabime gjatë vetë procesit të numërimit.

Megjithëse shumica e grupeve të numërimit u përpoqën t'i kryejnë detyrat e tyre në një mënyrë profesionale, raportet e vëzhgimit të marra në mbrëmjen e 19 shkurtit e vlerësuan numërimin si 'të keq' ose 'shumë të keq' në 23% të raporteve të dorëzuara. Vetëm disa KZQV arritën të përfundojnë numërimin e votave, nxjerrjen e rezultateve dhe dorëzimin e tyre në KQZ brenda afatit ligjor të orës 17:00 të datës 19 shkurt.¹

Roli i luajtur nga partitë politike në disa NjQV pas ditës së zgjedhjeve ishte larg të qenit konstruktiv. Në shumë vende numërimi vëzhguesit gjithashtu vunë re një numër më të lartë të vëzhguesve partiakë nga sa parashikohet në Kodin Zgjedhor. Përveç kësaj, prania e deputetëve të të dy palëve në disa nga vendet 'problematike' të numërimit ndikoi në rritjen e tensionit dhe në një atmosferë më polemike.

¹ ora 20:00 për Tiranën

Në 19% të vendeve të votimit të vizituara, u vunë re mosmarrëveshje lidhur me vlefshmërinë e fletëve të votimit. Diskutimet mes anëtarëve të grupeve të numërimit apo mes anëtarëve të KZQV-ve, si dhe mes grupeve të numërimit dhe KZQV-ve çuan në çrregullime dhe ndalesa gjatë numërimit. Në shumë vende, numërimi u bllokua pasi komisionerët që përfaqësonin interesa të ndryshme politike u larguan nga vendi i numërimit. Në 38% të numërimit që u vëzhgua, u vu re prania e personave të paautorizuar dhe në rreth një të tretën e këtyre rasteve këta persona ndërhyjnë në proces në mënyrë të pajustificuar. Në 19% të raporteve të tyre, vëzhguesit vunë re se persona të paautorizuar ose vëzhgues partiakë përpiqeshin të ndikonin në mënyrë të pajustificuar mbi grupet e numërimit dhe KZQV-të.

Në një numër të kufizuar NjQV-sh, vëzhguesit raportuan probleme të konsiderueshme. Procesi i vendimmarrjes u bllokua nga grupet e numërimit ose KZQV-të. Në disa raste KQZ-së iu desh të dërgonte inspektorët apo trainuesit rajonalë për të ndihmuar KZQV-të për të zgjidhur problemet me numërimin e votave apo me nxjerrjen e rezultateve.

Në bashkinë e Himarës (qarku Vlorë) mosmarrëveshjet mes kandidatëve të Partisë Demokratike dhe Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, mbi pretendimet për parregullsi në votime dhe mbi përbërjen e grupeve të numërimit, penguan procesin e numërimit qysh prej fillimit. Numërimi u zhvillua në një mjedis të tensionuar dhe u ndërpre në mënyrë të përsëritur. Më 20 shkurt KQZ-ja urdhëroi KZQV-në të përfundonte numërimin dhe dërgoi inspektorët që të ndihmonin me zgjidhjen e problemeve. Në Himarë u dërguan edhe përfaqësues të personelit të zyrës së Prokurorit të Vlorës. Numërimi i votave në Himarë përfundoi të enjten, më 21 shkurt.

Në komunën e Bushatit (qarku Shkodër) u numëruan vetëm kutitë e votimit të pesë prej 25 qendrave të votimit. KZQV-ja nuk mundi ta mbarojë numërimin për shkak të presionit prej një turme mbështetësish të kandidatëve konkurrues për kryetarë komune, të cilët ishin grumbullar jashtë vendit të numërimit. Konfrontimi përfundoi në dhunë dhe policisë iu desh të ndërhynte për për të rivendosur rendin. Në përfundim, KQZ-ja vendosi që i gjithë materiali zgjedhor të sillej në Tiranë dhe të numërohej nga KZQV-ja e Bushatit dhe nga dy grupe numërimi, në praninë e inspektorëve të KQZ-së.

Në bashkinë e Gjirokastrës problemet qenë të dukshme edhe para se të fillonte numërimi i votave, pasi anëtarët e KZQV-së të emëruar nga shumica parlamentare nuk u paraqitën për numërimin. Numërimi nisi vetëm pasi një përfaqësues i KQZ-së u takua veçmas me secilin nga dy kandidatët kryesorë. Megjithatë, edhe atëherë, numërimi u zhvillua në një atmosferë të tensionuar dhe u ndërpre herë pas here; pati gjithashtu një zënkë me grushte mes anëtarëve të një grupi numërimi. Pas nxjerrjes më 21 shkurt të rezultateve për kryetarin e bashkisë, tensioni u ul. Numërimi për këshillin përfundoi më 22 shkurt dhe rezultatet u nxorën të nesërmen.

Në komunën e Paskuqanit² KZQV-ja nuk zbatoi një vendim të KQZ-së që urdhëronte vazhdimin e numërimit të votave. Më pas, KQZ-ja vendosi të shkarkonte kryetarin e KZQV-së dhe të bënte kallëzim penal për dhjetë anëtarë të KZQV-së. Përveç kësaj, të gjithë anëtarët e KZQV-së dhe sekretari u gjobitën secili me 30,000 lekë³.

² qarku Tiranë

³ afërsisht 240 EUR

Në bashkinë e Durrësit, KZQV-ja nuk arriti të marrë vendim për rezultatin e kryetarit të bashkisë; anëtarët e emëruar nga shumica parlamentare votuan kundër nxjerrjes së rezultateve, duke kundërshtuar shpalljen si të pavlefshme të 1,189 fletëve të votimit gjatë numërimit. Më 23 shkurt u nënshkruan tabelat e rezultateve, por vetëm gjashtë anëtarët e emëruar nga pakica parlamentare votuan pro. Numërimi për këshillin përfundoi më 25 shkurt.

Në bashkinë e Elbasanit, nxjerrja dhe dërgimi i rezultateve u pengua nga një mosmarrëveshje mbi numërimin e një kutie votimi, sepse numri serial i njëres prej vulave të sigurisë mbi kuti nuk përputhej me protokollin zyrtar. Duke ditur që KZQV-ja nuk arriti të merrte një vendim mbi këtë kuti votimi, më 23 shkurt KQZ-ja urdhëroi KZQV-në të transportonte të gjitha materialet zgjedhore dhe dokumentacionin në Tiranë.

Në komunën e Hekalit⁴ ku procesi i numërimit gjithashtu u bllokua, më 23 shkurt KQZ-ja urdhëroi KZQV-në të transportonte të gjitha materialet zgjedhore, përfshirë edhe kutitë e votimit, në godinën e KQZ-së, të shoqëruara nga personeli i KQZ-së.

Ditën e zgjedhjeve dhe gjatë gjithë procesit të numërimit, forcat e policisë vazhduan të kryenin detyrat e tyre në një mënyrë profesionale. Ato arritën të ruanin rendin edhe në rrethana të cilat ndonjëherë ishin të vështira, dhe përfshirja e tyre u kërkua vetëm kur tensioni u kthye në dhunë fizike. Vëzhguesit vunë re punën veçanërisht të lavdërueshme të policisë gjatë procesit të numërimit të votave në Gjirokastrë.

Shpallja e rezultateve

Problemet që u raportuan në lidhje me programin kompjuterik për përpunimin e rezultateve të zgjedhjeve e penguan KQZ-në që të publikonte natën e zgjedhjeve të dhënat paraprake në faqen e saj të internetit, megjithëse ajo kishte marrë disa rezultate nga KQZV-të. Fillimisht, KQZ-ja u bazua mbi tabelat e rezultateve të dërguara me faks, por vetëm 152 KZQV kishin mundësi për të përdorur fakse. Më pas KQZ-ja publikoi rezultatet paraprake mbi bazën e tabelave përmbledhëse të rezultateve të dërguara dorazi nga KZQV-të te KQZ-ja. Dërgimi i të dhënave ishte veçanërisht i ngadaltë në qendrat e mëdha urbane. Deri më 25 shkurt KQZ-ja kishte shpallur rezultatet vetëm për 331 NjQV.

Ndërkohë që pjesa më e madhe e KZQV-ve i dërguan rezultatet e zgjedhjeve për NjQV-në e tyre në KQZ gjatë javës pas ditës së zgjedhjeve, ky proces u vonua në një numër NjQV-sh, ku mosmarrëveshjet mes partive politike ose kandidatëve e penguan procesin e numërimit dhe të shpalljes së rezultateve. Në përfundim kjo solli vonesa të mëdha në dërgimin dhe publikimin e rezultateve të zgjedhjeve, duke kapërcyer mjaft afatet kohore të parashikuara në Kodin Zgjedhor.

KQZ-ja mori vendime që synonin zhblokimin e procesit të numërimit në një numër NjQV-sh. Konkretisht, KQZV-të e Njësisë Bashkiake Nr.10 në Tiranë, Bashkisë së Durrësit dhe komunës së Hoçishtit u urdhëruan të dërgonin të gjitha dokumentet dhe materialet zgjedhore në KQZ megjithëse nuk kishte përfunduar nxjerrja e rezultateve dhe nuk ishin marrë vendime mbi shpalljen e rezultateve. Shpesh këto vendime mund të ishin marrë më parë, dhe me përjashtim

⁴ qarku Fier

të rastit të Bushatit, KQZ-ja nuk ka ndërmarrë hapa të mëtijshme pas urdhërave të dhëna në fillim për të dërguar të gjitha dokumentet dhe materialet zgjedhore në Tiranë, ku mund të përdoren si prova gjatë shqyrtimit të ankesave të mundshme.

Deri tani, numërimi i votave për këshillin e komunës së Shupenzës⁵ mbetet i bllokuar për shkak të një mosmarrëveshjeje mbi disa vota për këshillin, të cilat u gjetën në kutitë e votimit për kryetarin e komunës. Tre inspektorë të dërguar nga KQZ-ja më 25 shkurt nuk arritën ta zgjidhnin këtë çështje.

IV. ANKIMET DHE APELIMET PASZGJEDHORE

Gjatë periudhës 19-25 shkurt, në KQZ u paraqitën gjithsej 144 ankime. Këtu përfshihen 40 kërkesa për të shpallur pavlefshmerinë e zgjedhjeve në disa NJQV të caktuara dhe 28 kërkesa shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në disa qendra votimi të caktuara.⁶

Gjatë periudhës së raportimit janë shqyrtuar nga KQZ-ja në mbledhje publike 123 ankime dhe kërkesa për pavlefshmëri. Në më shumë se 60 raste, KQZ-ja ka shtyrë seancat me qëllim hetimin e provave të paraqitura. Rreth 55 ankime nuk u pranuan për shqyrtim për arsye procedurale, ndërkohë që shtatë ankime u hodhën poshtë si të pabazuara dhe/ose për mungesë provash. KQZ-ja pranoi gjatë raste; si rrjedhojë, rezultati i zgjedhjeve për këshillat vendore u rishikua në pesë NJQV, ashtu siç u rishikua rezultati për zgjedhjen e kryetarit të një NJQV-je.

Në përputhje me Nenin 161/2, pika 3 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja ka dhjetë ditë kohë për të marrë vendime mbi ankimet që kanë të bëjnë me rezultatin e zgjedhjeve. Deri tani KQZ-ja ka bërë përpjekje të vërteta për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në një mënyrë të përshtatshme dhe efikase, në përputhje me ndryshimet që iu bënë Kodit Zgjedhor më 13 Janar, që harmonizoi procedurat për shqyrtimin e ankimeve dhe kërkesave për pavlefshmëri. Gjithashtu, ndryshimet i dhanë qartazi të drejtën KQZ-së për të vlerësuar dokumentacionin dhe materialet zgjedhore, përfshirë dhe votat.

KQZ-ja do të shpallë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve lokale në nivel kombëtar vetëm pas zgjidhjes së të gjitha ankimeve dhe apeliave. Në qoftë se zgjidhja e këtyre mosmarrëveshjeve përfundon brenda afateve ligjore të parashikuara, 26 marsi do të ishte data e fundit për shpalljen e rezultateve në nivel kombëtar. Deri tani, një KZQV nuk ka përfunduar ende procesin e numërimit të votave, gjë që mund ta shtyjë shpalljen e rezultateve përfundimtare përtej 26 marsit.

Përveç procedurave administrative për të kërkuar zgjidhje të mosmarrëveshjeve, në zyrat e prokurorive janë paraqitur një numër kërkesash për fillimin e procedimeve penale. Zyra e Prokurorisë së Përgjithshme raportoi se në periudhën 18-20 shkurt janë paraqitur 36 kallëzime penale. Pjesa më e madhe e akuzave për vepra penale kishin të bënin me braktisjen e detyrës nga zyrtarët zgjedhorë dhe me kërcënimin e votuesve dhe kandidatëve. Një numër personash u

⁵ qarku Dibër

⁶ Një numër i konsiderueshëm ankimesh iu përkasin qarqeve të Fierit (14 për qind të të gjitha ankimeve të paraqitura), Lezhës (12 për qind), Elbasanit (11 për qind) dhe Gjirokastrës (9 për qind).

ndaluan në lidhje me këto zgjedhje; në komunën e Ndroqit⁷, 3 persona u ndaluan në lidhje me një incident serioz dhune gjatë procesit të numërimit të votave, dhe njëri prej tyre u mbajt në paraburgim. Si pasojë e këtij incidenti një person u plagos rëndë dhe u desh të shtrohej në spital.

Në Tiranë, u bënë kallëzime kundër Kryetarit, Sekretarit të Përgjithshëm dhe atij organizativ të Partisë Balli Kombëtar Demokrat për falsifikimin e firmave në lidhje me kërkesën për regjistrim si kandidat për kryetar bashkie në Tiranë të Z. Akile Rama. Ndaj dy të parëve u dha masa e arrestit me burg, ndërsa ndaj të tretit masa me arrest shtëpie.

MVZ i OSBE/ODIHR do të vazhdojë të ndjekë trajtimin e ankimeve dhe apelimeve nga KQZ-ja dhe Kolegji Zgjedhor.

⁷

Qarku Tiranë